



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

RREGULLORE PËR SHPALLJEN E LAUREATËVE TË VITIT NË BASKETBOLL

Prishtinë, 06.11.2024



PËRMBAJTJA:

NENI 1 - QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I RREGULLORES	3
NENI 2 - LAUREATËT E VITIT NË BASKETBOLL	3
NENI 3 - KRITERET DHE POENTIMI	4
NENI 4 - VENDIMI PËR ÇMIMET	8
NENI 5 - SHPËRBLIMI FINANCIAR.....	9
NENI 6 - PROCEDURA	9
NENI 7 - ZBATIMI DHE TRANSPARENCA	10
NENI 8 - DISPOZITAT PËRFUNDIMATRE.....	11



Mbështetur në Nenin 23, paragrafi 1, alineja 1.28. të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së më 06.11.2024 miraton këtë:

RREGULLORE PËR SHPALLJEN E LAUREATËVE TË VITIT NË BASKETBOLL

NENI 1 - QËLLIMI DHE FUSHËVEPRIMI I RREGULLORES

1. Kjo Rregullore përcakton kriteret, kushtet dhe procedurën për shpalljen e laureatëve të vitit në basketboll në Republikën e Kosovës për klubet dhe anëtarët e FBK-së.
2. Gjithashtu Rregullorja përcakton llojet e çmimeve dhe shpërblimet për secilin çmim.
3. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga Federata e Basketbollit e Kosovës, klubet dhe anëtarët e FBK-së.

NENI 2 - LAUREATËT E VITIT NË BASKETBOLL

1. Federata e Basketbollit e Kosovës bën shpalljen e laureatëve të vitit në basketboll, përmes këtyre çmimeve:
 - 1.1. Basketbollisti i vitit;
 - 1.2. Basketbollistja e vitit;
 - 1.3. Pesë (5) basketbollistët më të dalluar të vitit;
 - 1.4. Pesë (5) basketbollistet më të dalluara të vitit;
 - 1.5. Skuadra më e mirë në konkurrencën e meshkujve;
 - 1.6. Skuadra më e mirë në konkurrencën e femrave;
 - 1.7. Trajneri më i mirë i vitit;
 - 1.8. Shpresa e vitit tek djemtë;
 - 1.9. Shpresa e vitit tek vajzat;
 - 1.10. Gjyqtari i vitit;
 - 1.11. Punëtori më i dalluar i vitit;
 - 1.12. Ambasadori/ja i/e basketbollit të Kosovës jashtë vendit;
 - 1.13. Mirënjohje të tjera.



2. Çmimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Neni ndahen çdo vit dhe ndarja bëhet në një ceremoni solemne të organizuar nga FBK gjatë muajit Dhjetor.

NENI 3 - KRITERET DHE POENTIMI

1. Kriter për shpalljen e **basketbollistit dhe basketbollistes** së vitit janë:

1.1. Rezultatet në gara ndërkombëtare (Basketball Champions League, FIBA Europe Cup, EuroLeague Women, EuroCup Women);

1.2. Rezultatet në gara vendore (Kampionati i Kosovës, Kupa e Kosovës, Superkupa e Kosovës);

1.3. Pjesëmarrja dhe performanca me Përfaqësuese të Kosovës;

1.4. Sjellja profesionale dhe lidershipi në ekip (përmes vlerësimeve nga trajnerët dhe kolegët e ekipit);

1.5. Kontributi në komunitet, përmes angazhimeve në aktivitete sociale, bamirësi dhe nisma që promovojnë basketbollin dhe edukimin përmes sportit.

2. Kriter për shpalljen e **pesë (5) basketbollistëve dhe pesë (5) basketbollisteve më të dalluar/a** janë:

2.1. Rezultatet në gara ndërkombëtare (Basketball Champions League, FIBA Europe Cup, EuroLeague Women, EuroCup Women);

2.2. Rezultatet në gara vendore (Kampionati i Kosovës, Kupa e Kosovës, Superkupa e Kosovës);

2.3. Pjesëmarrja dhe performanca me Përfaqësuese të Kosovës;

2.4. Sjellja profesionale dhe lidershipi në ekip (përmes vlerësimeve nga trajnerët dhe kolegët e ekipit);

2.5. Kontributi në komunitet, përmes angazhimeve në aktivitete sociale, bamirësi dhe nisma që promovojnë basketbollin dhe edukimin përmes sportit.

3. Kriter për shpalljen e **skuadrës** së vitit për meshkuj dhe femra janë:

3.1. Rezultatet në gara ndërkombëtare (Basketball Champions League, FIBA Europe Cup, etj.)

3.1.1. Renditja në kampionate ndërkombëtare dhe kualifikimi në fazat më të larta të garave;



- 3.1.2.** Numri i fitoreve ndaj ekipeve të nivelit të lartë në gara ndërkombëtare.
- 3.2.** Rezultatet në gara vendore (Kampionati i Kosovës, Kupa e Kosovës, Superkupa e Kosovës)
- 3.2.1.** Renditja përfundimtare në kampionatin vendor dhe në garat e tjera vendore.
- 3.2.2.** Stabiliteti dhe qëndrueshmëria e skuadrës gjatë sezonit në nivel kombëtar.
- 3.3.** Kohezioni dhe organizimi i ekipit
- 3.3.1.** Vlerësimi i mënyrës se si skuadra funksionon si një njësi e koordinuar.
- 3.3.2.** Përdorimi efektiv i lojtarëve të rinj dhe lojtarëve me përvojë.
- 3.3.3.** Lidhja dhe bashkëpunimi mes lojtarëve dhe stafit teknik.
- 3.4.** Zhvillimi i lojtarëve të rinj
- 3.4.1.** Përfshirja dhe zhvillimi i lojtarëve të rinj në ekipin e parë.
- 3.4.2.** Kontributi i skuadrës në prodhimin e talentëve të rinj që përfaqësojnë Kosovën në nivel ndërkombëtar.
- 3.5.** Sjellja sportive dhe fair-play
- 3.5.1.** Sjellja e ekipit gjatë ndeshjeve dhe respektimi i rregullave të fair-play.
- 3.5.2.** Numri i penaliteteve dhe ndëshkimeve disiplinore gjatë sezonit.
- 3.6.** Angazhimi në komunitet
- 3.6.1.** Përfshirja e ekipit në aktivitete sociale, promovimi i basketbollit në komunitet dhe nisma të tjera që kontribuojnë në rritjen e interesit për sportin.
- 3.6.2.** Organizimi i aktiviteteve bamirëse, kampeve sportive për të rinjtë, dhe aktiviteteve të tjera të ngjashme.
- 4.** Kriter për shpalljen e **trajnerit** të vitit janë:
- 4.1.** Rezultatet sportive të skuadrës
- 4.1.1.** Rezultatet në gara vendore dhe ndërkombëtare të skuadrës së tij/saj;
- 4.1.2.** Renditja e skuadrës në kampionate dhe gara;
- 4.1.3.** Rezultate me Përfaqësueset e Kosovës.



4.2. Zhvillimi i lojtarëve

4.2.1. Përfshirja e lojtarëve të rinj dhe zhvillimi i tyre.

4.2.2. Ndikimi në përparimin e lojtarëve individualë dhe përgatitja e tyre për nivele më të larta.

4.3. Lidershipi, sjellja profesionale dhe motivimi

4.3.1. Lidershipi dhe aftësia për të motivuar ekipin, veçanërisht në situata të vështira.

4.3.2. Krijimi i një fryme bashkëpunimi dhe respekti brenda skuadrës.

4.3.3. Sjellja gjatë ndeshjeve dhe respektimi i rregullave të fair-play.

5. Kriter për shpalljen e **shpresave të vitit** në konkurrencën e djemve dhe vajzave janë:

5.1. Performanca individuale në gara kombëtare dhe ndërkombëtare;

5.1.1. Rezultatet dhe kontributi në ekip, si në gara kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare.

5.2. Zhvillimi dhe përmirësimi gjatë vitit

5.2.1. Përparimi personal dhe zhvillimi i aftësive gjatë vitit.

5.2.2. Progresi nga një nivel fillestar drejt një lojtari më të kompletuar dhe të aftë për përfaqësim në nivele më të larta.

5.3. Pjesëmarrja në Përfaqësuese të Kosovës

5.3.1. Kontributi në ekipin kombëtar dhe rezultatet e arritura në ndeshjet ndërkombëtare.

5.4. Sjellja dhe etika sportive

5.4.1. Respektimi i rregullave të lojës dhe sjellja në ekip dhe ndaj kundërshtarëve.

6. Kriter për shpalljen e **gjyqtarit** të vitit janë:

6.1. Performanca në gara kombëtare dhe ndërkombëtare

6.1.1. Vlerësimi i korrektësisë dhe profesionalizmit gjatë ndeshjeve të drejtuara.

6.1.2. Vlerësimet nga instruktori nacional dhe përgjegjësit në nivel ndërkombëtar.

6.2. Numri i ndeshjeve të drejtuara në nivel ndërkombëtar

6.3. Aftësitë për menaxhimin e ndeshjeve të vështira



6.3.1. Aftësia për të menaxhuar situata të tensionuara dhe të mbajë kontrollin e ndeshjes në raste të vështira.

6.4. Etika dhe sjellja profesionale

6.4.1. Sjellja etike dhe korrektësia ndaj lojtarëve dhe trajnerëve gjatë ndeshjeve.

7. Kriter për shpalljen e **punëtorit** më të dalluar janë:

7.1. Kontributi për organizimin e aktiviteteve të basketbollit

7.1.1. Roli aktiv në organizimin e kampionateve, garave dhe aktiviteteve të ndryshme sportive.

7.1.2. Përkushtimi ndaj klubit dhe përmirësimit të basketbollit në vend.

7.1.3. Bashkëpunimi me Federatën dhe institucionet/organizatat e tjera.

7.2. Inovacionet në zhvillimin e infrastrukturës ose aktiviteteve sportive

7.2.1. Shtyrja përpara e projekteve inovative për përmirësimin e infrastrukturës dhe kushteve të basketbollit në vend.

7.3. Përkushtimi ndaj zhvillimit të basketbollit për të rinjtë

7.3.1. Organizimi i kampeve sportive, nismave për përfshirjen e të rinjve dhe aktivitetet që ndihmojnë në edukimin e brezave të rinj përmes basketbollit.

7.4. Angazhimi në promovimin e basketbollit në komunitet

7.4.1. Aktivitetet për promovimin e sportit në komunitet, si përfshirja e shkollave, organizatave dhe komuniteteve lokale në projekte sportive.

7.5. Sjellja profesionale dhe ndershmëria

7.5.1. Sjellja etike dhe angazhimi ndaj parimeve të sportit dhe federatës.

8. Kriteret për shpalljen **Ambasadorit/es të basketbollit të Kosovës jashtë vendit:**

8.1. Performanca apo puna në kampionatet apo organizatat e huaja (p.sh. garat ndërkombëtare, ligat kombëtare të huaja, përfaqësimi në institucionet/organizatat ndërkombëtare) dhe kontributi i tij/saj në suksesin e ekipit/organizatës;



8.2. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i Kosovës: Vlerësohet pjesëmarrja e tij/saj në ndeshjet e ekipit kombëtar të Kosovës ose në promovimin e imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare;

8.3. Sjellja profesionale dhe përfaqësimi i denjë i Kosovës në vendin e huaj: Vlerësohet ndikimi pozitiv i individit në imazhin e Kosovës jashtë vendit, përmes sjelljes sportive dhe angazhimit në komunitet.

9. Kriteret e përgjithshme që duhet të përmbushen nga laureatët e çmimeve në basketboll janë:

9.1. Basketbollisti/basketbollistja, shpresat, trajneri, gjyqtari, punëtori i dalluar sportiv etj. duhet të jenë qytetarë të Republikës së Kosovës.

9.2. Basketbollisti/basketbollistja që ka mbush moshën 12 vjeç deri në ditën që i mbushë 18 vjeç konsiderohet shpresë e basketbollit dhe i llogariten të gjitha rezultatet e arritura deri në ditën kur i mbush 18 vjeç.

9.3. Basketbollisti/basketbollistja, shpresat, trajneri, gjyqtari, punëtori i dalluar sportiv etj., përpos ambasadorit/es së basketbollit të Kosovës jashtë vendit, duhet të zhvillojnë aktivitetin me ekipet vendore (Kosovë).

10. Cikli për shpalljen e laureatëve të vitit në basketboll nis me fillimin e vitit dhe përfundon në përmbyllje të po njëjtit vit.

11. Nëse gjatë vlerësimit të Komisionit, pikët në ndonjërin kategori janë të barabarta, përparësi duhet të ketë gara ndërkombëtare që ka nivelin më të lartë, ose gara vendore që ka nivelin më të lartë.

12. Tabela e poentimit për secilin çmim i është bashkëngjitur kësaj Rregullore në formë të Shtojcës.

NENI 4 - VENDIMI PËR ÇMIMET

1. Bordi Ekzekutiv i Federatës së Basketbollit të Kosovës çdo vit emëron Komisionin për shpalljen e laureatëve të vitit në basketboll.

2. Komisioni përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, sipas kësaj përbërje:

2.1. Dy anëtarë të Bordit të FBK-së;

2.2. Një ish-basketbollist eminent vendor;

2.3. Një ish-basketbolliste eminente vendore;



2.4. Një gazetarë/e të sportit (preferohet nga fusha e basketbollit), të cilët i propozon Shoqata e Gazetarëve Sportiv të Kosovës; dhe

3. Kryesues i Komisionit është një nga dy anëtarët e Bordit të FBK-së.

4. Në mbledhjet e Komisionit merr pjesë edhe Sekretari i Përgjithshëm i FBK-së, mirëpo, vetëm në cilësinë e këshillëdhënësit dhe pa të drejtë vote apo vendimmarrje.

5. Pas përfundimit të vlerësimit Komisioni i rekomandon Bordit të FBK-së për marrje të vendimit. Bordi i FBK-së me shumicë të votave vendosë ti pranoj ose ti refuzoj rekomandimet e Komisionit.

6. Bordi i FBK-së nxjerr vendimin për shpalljen e laureatëve të vitit në basketboll, pas rekomandimit të Komisionit.

NENI 5 - SHPËRBLIMI FINANCIAR

1. Çmimet vjetore për basketboll nga FBK shoqërohen edhe me shpërblim financiar.

2. Lartësinë e shpërblimit financiar për secilin çmim e përcakton Bordi i FBK-së për çdo vit.

NENI 6 - PROCEDURA

1. Federata e Basketbollit e Kosovës u dërgon shkresë klubeve të saj, përmes të cilës kërkon nominimin e laureatëve të vitit në basketboll për të gjitha çmimet nga një nominim.

2. Kërkesa për nominim duhet të dërgohet më së largu tri javë para ceremonisë dhe klubet duhet ti përcjellin nominimet e tyre brenda shtatë (7) ditëve nga pranimi i kërkesës.

3. Klubet kanë të drejtë të nominojnë nga një laureat për secilin çmim, pra një basketbollist, një basketbolliste për të mirët e vitit, pesë basketbollistë më të dalluar të vitit, pesë basketbolliste më të dalluara të vitit, një ekip të meshkujve (ekipet e meshkujve), një ekip të femrave (ekipet e femrave), një



shpresë tek djemtë, një shpresë tek vajzat, një trajner, një gjyqtar, një punëtor sportiv etj.

4. Bordi i FBK-së ka të drejtë të nominoj nëse e sheh të arsyeshme nga një laureat për secilin çmim.

5. Nominimi nga klubet përkatëse, duhet ti bëhet përmes formularit për nominimin e laureatit të vitit në basketboll, të cilin e përgatitë zyra ekzekutive e FBK-së dhe e miraton Bordi i FBK-së.

6. Komisionit duhet të vlerësojë aplikimet brenda shtatë (7) ditëve nga dita e mbylljes së aplikimit.

7. Ceremonia e shpalljes së laureatëve të vitit në basketboll duhet të bëhet gjatë muajit Dhjetor të vitit pasues, para Festave të Fundvitit.

NENI 7 - ZBATIMI DHE TRANSPARENCA

1. Komisioni për shpalljen e laureatëve është i detyruar të mbajë dokumentacion të detajuar për çdo vendim të marrë gjatë procesit të vlerësimit, përfshirë formularët e poentimit dhe vlerësimet individuale të secilit anëtar të Komisionit.

2. Pas përfundimit të procesit të vlerësimit dhe miratimit nga Bordi i FBK-së, rezultatet përfundimtare, përfshirë arsyetimet kryesore dhe poentimet e përgjithshme, do të publikohen në faqen zyrtare të Federatës dhe në mediat përkatëse.

3. Çdo klub ose kandidat ka të drejtë të kërkojë informacion të detajuar mbi mënyrën se si janë marrë vendimet dhe të kërkojë shpjegime për vendimet përfundimtare.

4. Çdo vit, pas përfundimit të ceremonisë së ndarjes së çmimeve, Federata do të përgatit pyetësorë rreth procesit të vlerësimit dhe transparencës së tij. Kjo do të ofrojë mundësi për sugjerime për përmirësime të mëtejshme.



NENI 8 - DISPOZITAT PËRFUNDIMATRE

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i FBK-së.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje i propozon Sekretari i Përgjithshëm, të cilat i miraton Bordi i FBK-së.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben **FETAHU**

Kryetar

Federata e Basketbollit të Kosovës

Prishtinë, 06.11.2024





SHTOJCA 1 - TABELA E POENTIMIT PËR SECILIN ÇMIM

Çmimi	Kriteret	Pikët
1. Basketbollisti/ja e vitit	Rezultatet në gara ndërkombëtare	0 - 35
	Rezultatet në garat vendore	0 - 30
	Pjesëmarrja dhe performanca me Përfaqësuesen	0 - 20
	Sjellja profesionale dhe lidershipi	0 - 10
	Kontributi në komunitet	0 - 5
2. Top 5 basketbollistët/et e vitit	Rezultatet në gara ndërkombëtare	0 - 35
	Rezultatet në garat vendore	0 - 30
	Pjesëmarrja dhe performanca me Përfaqësuesen	0 - 20
	Sjellja profesionale dhe lidershipi	0 - 10
	Kontributi në komunitet	0 - 5
3. Skuadra e vitit	Rezultatet në gara ndërkombëtare	0 - 40
	Rezultatet në garat vendore	0 - 30
	Kohezioni dhe organizimi i ekipit	0 - 10
	Zhvillimi i lojtarëve të rinj	0 - 10
	Sjellja sportive dhe fair-play	0 - 5
	Angazhimi në komunitet	0 - 5
4. Trajneri i vitit	Rezultatet sportive të skuadrës	0 - 50
	Zhvillimi i lojtarëve	0 - 30
	Lidershipi, sjellja profesionale dhe motivimi	0 - 20
5. Shpresat e vitit	Performanca individuale në gara kombëtare dhe ndërkombëtare	0 - 40
	Zhvillimi dhe përmirësimi gjatë vitit	0 - 20
	Pjesëmarrja në Përfaqësuese të Kosovës	0 - 20
	Sjellja dhe etika sportive	0 - 20
6. Gjyqtari i vitit	Performanca në gara kombëtare dhe ndërkombëtare	0 - 50
	Numri i ndeshjeve të drejtuara në nivel kombëtar	0 - 20
	Aftësitë për menaxhimin e ndeshjeve të vështira	0 - 20
	Etika dhe sjellja profesionale	0 - 10
7. Punëtori më i dalluar i vitit	Kontributi për organizimin e aktiviteteve të basketbollit	0 - 40
	Inovacionet për zhvillimin e infrastrukturës ose aktiviteteve sportive	0 - 20
	Përkushtimi ndaj zhvillimit të basketbollit për të rinjtë	0 - 20
	Angazhimi në promovimin e basketbollit në komunitet	0 - 10
	Sjellja profesionale dhe ndershmëria	0 - 10
8. Ambasadori/ja i/e Basketbollit të Kosovës jashtë vendit	Performanca apo puna në kampionatet/organizatat e huaja	0 - 50
	Pjesëmarrja dhe përfaqësimi i Kosovës	0 - 30
	Sjellja profesionale, përfaqësimi i denjë i Kosovës në vendin e huaj	0 - 20